**VENDIM**
**Nr. 205, datë 9.4.2014**

# PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA HAPJA DHE NDËRTIMI I UNAZËS VERIORE, SEGMENTI A-B NË LAGJEN "11 NËNTORI", HAPJA DHE SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË UNAZËS SË BRENDSHME, SEGMENTI QË BASHKON RRUGËN "28 NËNTORI" ME RRUGËN "RINIA", SI DHE HAPJA E SISTEMIMI I ZGJATIMIT TË RRUGËS "LEF NOSI", LAGJJA "5 MAJI", SEGMENTI B-C, TË BASHKISË SË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga hapja dhe ndërtimi i unazës veriore, segmenti A-B në lagjen "11 Nëntori", hapja dhe sistemimi i zgjatimit të unazës së brendshme, segmenti që bashkon rrugën "28 Nëntori" me rrugën "Rinia", hapja dhe sistemimi i zgjatimit të rrugës "Lef Nosi", lagjja "5 Maji", segmenti B-C", të Bashkisë së Elbasanit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Elbasanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave të mëposhtme:

a) Për sipërfaqet 1 595.4 (një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë katër) m², truall, dhe 799.56 (shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e gjashtë) m², banesë, në segmentin A-B, në lagjen "11 Nëntori", në vlerën 50 263 894.4 (pesëdhjetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e katër pikë katër) lekë;

b) Për sipërfaqet 1 278.55 (një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë pikë pesëdhjetë e pesë) m², truall, dhe 99.3 (nëntëdhjetë e nëntë pikë tre) m², banesë, në segmentin që bashkon rrugën "28 Nëntori" me rrugën "Rinia", në vlerën 15 251 225.9 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e dyqind e njëzet e pesë pikë nëntë) lekë;

c) Për sipërfaqet 556.28 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzet e tetë) m², truall, dhe 549.25 (pesëqind e dyzet e nëntë pikë njëzet e pesë) m², banesë, në segmentin B-C, në lagjen "5 Maji", në vlerën 27 295 701.7 (njëzet e shtatë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e një pikë shtatë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 92 810 822.05 (nëntëdhjetë e dy milionë e tetëqind e dhjetë mijë e tetëqind e njëzet e dy pikë zero pesë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Elbasanit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale përballohet nga Bashkia e Elbasanit.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

7. Regjistrimi i ri i pasurive për sipërfaqet 1 595.4 m², truall, dhe 799.56 m², banesë, për segmentin A-B në lagjen "11 Nëntori", sipërfaqet 1 278.55 m², truall, dhe 99.3 m², banesë, për segmentin që bashkon rrugën "28 Nëntori" me rrugën "Rinia", dhe sipërfaqet 556.28 m², truall, dhe 549.25 m², banesë, për segmentin B-C në rrugën "Lef Nosi", lagjja "5 Maji", të Bashkisë së Elbasanit, të bëhet në favor të kësaj bashkie.

8. Afati i përfundimit të punimeve të objekteve në Bashkinë e Elbasanit të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT PËR EFEKT TË HAPJES SË UNAZËS SË BRENDSHME SEGMENTI QË BASHKON RRUGËN “28 NËNTORI” ME RRUGËN RINIA” NË BASHKINË E ELBASANIT

| Nr. | Familja që shpronësohet | Nr. | Vërtetim pronësie m² | | | Sip. truall | Çmimi | Shpronësim | Sip. banese m² | | Çmimi | Shuma lekë | Sip. e njësisë m² | | Çmimi | Shuma lek | Shpronësim | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Pasuri | truall | banese | njësi | shpronësim | lekë m² | truall lekë | preket | shpronësim | lekë m² | Shpronësim banese | preket | shpronësim | lekë m² | shpronësim njësi | drufrutorë lekë | shpronësim lekë |
| 1 | Gazmend Faslli Selimaj | 6/362 | 49.6 | 0 | 49.6 | 49.6 | 5583 | 276916.8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 49.6 | 49.6 | 68217 | 3383563.2 | 0 | 3660480 |
| 2 | Oktavian Jani Gjoni Vangjel Jani Gjoni Lumnie Jani Gjoni | 6/104 | 1180 | 99.3 | 0 | 743.45 | 5583 | 4150681.35 | 99.3 | 99.3 | 43617 | 4331168.1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 287150 | 8768999.45 |
| 3 | Demir Kamer Hyskja | 6/447 | 794 | 99.2 | 0 | 485.5 | 5583 | 2710546.5 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 111200 | 2821746.5 |
| | | | | | | **1278.55** | | **7138144.65** | | | | **4331168.1** | | | | **3383563.2** | **398350** | **15251225.95** |

## TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT TË FAMILJEVE PËR EFEKT TË ZGJATIMIT TË RRUGËS “LEF NOSI: LAGJJA “5 MAJ” (SEGMENTI NGA KRYQËZIMI ME RRUGËN “IBRAHIM DINÇI” DERI NË BASHKIMIN ME UNAZËN VERIORE SEGMENTI “B-C”

| Nr. | Familja që shpronësohet | Nr. i pasurisë | Vërtetim pronës. | | Sip. truall m² shpronësohet | Vlera lekë/m² | Vlera lekë | Sip. banesë m² | | Vlera lekë/m² | Shuma lekë shpron. banese | Drufrutor lekë | Shuma shpronësimit, banesë+truall+dru | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | truall | banesë | | | | preket | shpronës | | | | | |
| 1 | Adem Sali Shabani | 13/204 | 258.6 | 211.9 | 149 | 13235 | 1972015 | 18.11 | 18.11 | 35965 | 651326.15 | 68000 | 2691341.15 | ndërtesë 2-katëshe |
| 2 | Çelo Mustafa Çelaj | 13/114 | 0 | 80.6 | 0 | 13235 | 0 | 80.6 | 80.6 | 35965 | 2898779 | 0 | 2898779 | vetëm ndërtesë pa truall |
| 3 | Fuat Nexhip Merolli | 13/105 | 367.31 | 70.75 | 28 | 13235 | 370580 | 0 | 0 | 35965 | 0 | 19500 | 390080 | vetëm truall |
| 4 | Ramazan Qazim Zelli | 13/137 | 0 | 66.5 | 0 | 13235 | 0 | 66.5 | 66.5 | 35965 | 2391672.5 | 0 | 2391672.5 | vetëm ndërtesë pa truall |
| 5 | Agim Mahmut Likrama | 13/138 | 0 | 71 | 0 | 13235 | 0 | 71 | 71 | 35965 | 2553515 | 0 | 2553515 | vetëm ndërtesë pa truall |
| 6 | Petro Anastas Topi | 13/201 | 286.9 | 72.5 | 120.66 | 13235 | 1596935.1 | 21.92 | 72.5 | 35965 | 2607462.5 | 74000 | 4278397.6 | |
| 7 | Bardhull Daut Vaska | 13/406 | 268.7 | 77.8 | 110.86 | 13235 | 1467232.1 | 52 | 52 | 35965 | 1870180 | 17700 | 3355112.1 | |
| 8 | Kujtim Daut Vaska | 13/407 | 69 | 13.37 | 0.76 | 13235 | 10058.6 | 0.76 | 13.36 | 35965 | 480852.05 | 0 | 490910.65 | |
| | | 13/408 | 39.9 | 17.18 | 23.9 | 13235 | 316316.5 | 13.4 | 17.18 | 35965 | 617878.7 | 0 | 934195.2 | |
| 9 | Durim Refat Dyrma | 13/139 | 0 | 53.7 | 0 | 13235 | 0 | 53.7 | 53.7 | 35965 | 1931320.5 | 0 | 1931320.5 | vetëm ndërtesë pa truall |
| 10 | Eduard Haxhi Koshi | 13/178 | 160.4 | 51.4 | 67.5 | 13235 | 893362.5 | 18.8 | 51.4 | 35965 | 1848601 | 0 | 2741963.5 | |
| 11 | Muhamet Isak Duka | 13/179 | 98.4 | 52.9 | 55.6 | 13235 | 735866 | 17.6 | 52.9 | 35965 | 1902548.5 | 0 | 2638414.5 | në proces legalizimi |
| | | | | | **556.28** | | **7362366** | | **549.25** | | **19754136** | **179200** | **27295701.7** | |

# TABELË PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË SHPRONËSIMIT TË FAMILJEVE PËR EFEKT HAPJES UNAZËS VERIORE, SEGMENTI “A-B”, LAGJJA “11 NËNTORI” ZK 8525

| Nr. | Familja që shpronësohet | Nr. i pasurisë | Vërtetim pronës. truall | Vërtetim pronës. banesë | Sip. truallit $m^2$ që shpronësohet | Çmimi lekë/$m^2$ | Shpronës. truall Vlera lekë | Sip, banesës $m^2$ preket | Sip, banesës $m^2$ shpronës. | Çmimi lekë/$m^2$ | Shpron. banese Vlera lekë | Drufrutorë Vlera lekë | Shuma e shpronësimit, lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Dhimitraq Filip Hasa | 11/76 | 336.7 | 131.7 | 51.85 | 13235 | 686234.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 38400 | 724634.75 |
| 2 | Tomorr Filip Hasa<br>Margarita Todi Hasa<br>Kristina Filip Hasa<br>Agim Filip Hasa | 11/15 | 1458.42 | 247.85 | 458.28 | 13235 | 6065335.8 | 159.55 | 247.85 | 35965 | 8913925.25 | 82700 | 15061961.05 |
| 3 | Nikollaq Filip Hasa<br>Kostandin Filip Hasa | 11/64 | 276 | 116.6 | 183.53 | 13235 | 2429019.55 | 116.6 | 116.6 | 35965 | 4193519 | 0 | 6622538.55 |
| 4 | Kalije Kostandin Hasa<br>Edmond Lefi Hasa | 11/9 | 305 | 88.8 | 204.74 | 13235 | 2709733.9 | 66.5 | 88.8 | 35965 | 3193692 | 22100 | 5925525.9 |
| 5 | Nazmije Ibrahim Rama<br>Shqiponja Xhaferr Rama<br>Arjan Xhaferr Rama | 11/63 | 40.7 | 40.7 | 40.7 | 13235 | 538664.5 | 40.7 | 40.7 | 35965 | 1463775.5 | 0 | 2002440 |
| 6 | Arif Selim Rama | 11/68 | 41 | 41 | 41 | 13235 | 542635 | 41 | 41 | 35965 | 1474565 | 0 | 2017200 |
| 7 | Shpetim Selim Rama | 11/67 | 53.8 | 53.8 | 53.8 | 13235 | 712043 | 53.8 | 53.8 | 35965 | 1934917 | 0 | 2646960 |
| 8 | Eduard Nikolla Ranxha | 11/51 | 0 | 90 | | 0 | 0 | 60 | 90.79 | 35965 | 3265262.35 | 0 | 3265262.35 |
| 9 | Mersin Sherif Rama | 11/78 | 0 | 63.62 | 295.00 | 13235 | 3904325 | 48 | 63.62 | 35965 | 2288093.3 | 118000 | 6310418.3 |
| 10 | Ali Rama | 11/74 | 0 | 56.47 | 266.5 | 13235 | 3527127.5 | 18 | 56.4 | 35965 | 2028426 | 131400 | 5686953.5 |
| | | | | | 0 | | **21115119** | | | | **28756175.4** | **392600** | **50263894.4** |